



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborui Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.156/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër koalicionit “Sloboda”, Nenad Rasic, me seli në Graçanicë, për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** e bazuar ankesa e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, Anr.156/2019 e datës 01.10.2019, dhe subjektit politik-koalicionit “Sloboda”, me seli në Graçanicë, për shkak të *përdorimit i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve*, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5,100.00 (pesë mijë e njëqind) euro për të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

**II. Urdhërohet** koalicioni “Sloboda”, Nenad Rasic, me seli në Graçanicë, që brenda afatit prej 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi, ta përmirësoj shkeljen e përcaktuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

## A r s y e t i m

Me datë 01.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën pretendon se kandidati për deputet nga radhët e koalicionit “Sloboda”, Nenad Rasic, në emër të subjektit politik, në profilin e tij zyrtar në facebook, ka publikur një video spot, në të cilin kandidati në fjalë, gjatë fjalimit të tij, flet kundër subjektit politik Lista Serbe, duke përdorë gjuhë të urrejtjes, në atë mënyrë që e ka quajtur këtë parti parlamentare “Monstrum” dhe ka thirrur se duhet të “hiqet qafe” ky monstrumi, veprime këto të cilat sipas paraqitësit të ankesës bien në kundërshtim me nenin 33 par.1 të LZP-së dhe Rregullën Zgjedhore, sepse në mënyrën më direkte të mundshme, fyen anëtarët e Listës Serbe, gratë dhe burrat, të cilët kryejnë detyrën e tyre me përgjegjësi dhe sinqeritet nga niveli lokal e deri tek ai qendror. Sipas tij, me fyerjet e tilla, thirret drejtpërdrejtë në dhunë ndaj Listës Serbe.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesë, ka bashkangjitur një video incizim dhe disa fotografi nga spoti, të cilin kandidati në fjalë, e ka publikuar, në kanalin e tij zyrtar në Youtube, si dhe në profilin e tij personal në facebook.

Më datë 02.10.2019, PZAP-i, e njoftoi koalicionin “Sloboda”, Nenad Rastic, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 03.10.2019 në ora 09:00, por deri në këtë kohë, PZAP-i, nuk mori ndonjë përgjigje nga koalicioni në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga CD-ja, fotografitë e ofruara si provë dhe shkresat e tjera të lëndës, shihet qartë se nga ana e koalicionit “Sloboda”, Nenad Rasic, është shkelur dispozita e nenit 33 pika l), e LZP-së, e cila ndër të tjera përcakton se; *‘Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve’*, për faktin se në spotin e kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit “Sloboda”, Nenad Rasic, gjatë fjalimit të tij është përdorë gjuhë e urrejtjes kundër subjektit politik Lista Serbe, duke e quajtur subjektin në fjalë “Monstrum”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit “Sloboda” respektivisht kandidati për deputet nga ky koalicion: Nenad Rasic, është shkelur dispozita e lartëcekur e LZP-së, si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t’i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit të koalicionit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se kandidati për deputet nga radhët e koalicionit “Sloboda”, Nenad Rasic, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, i’ a dha mundësinë për tu përgjigjur në

ankesë, por i njëjti nuk u deklarua me përgjigje ndaj ankesës lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës. Mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së urdhëroi koalicionin “Sloboda”, Nenad Rasic, që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljet në afatin prej 24 orëve dhe nëse i njëjti nuk vepron sipas urdhrit të panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i , në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr. 156/2019 më datë 04.10.2019

**Kryesues i Panelit**

Faton Ademi

***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.

